

REZULTATET E GËRMIMEVE ARKEOLOGJIKE TË VITIT 1970

Spektori i arkeologjisë i Institutit të historisë dhe gjuhësisë nga viti në vit po e shton fushën e veprimtarisë së tij kërkimore. Duke punuar në drejtime të ndryshme, në përputhje me detyrat që i dalin përpara arkeologjisë sonë, gjatë vitit 1970 u ndërmorën një varg gërmimesh në qendra të rëndësishme arkeologjike të vendit tonë, duke zgjeruar kështu sferën e kërkimeve edhe në qendra të reja. Ekspeditat po japin gjithnjë e më tepër materiale të reja me rëndësi të madhe shkencore dhe po hedhin dritë të re mbi disa probleme të rëndësishme të arkeologjisë dhe të së kaluarës së largët të popullit tonë.

Po paraqesim këtu më poshtë qendrat ku kanë punuar ekspeditat e këtij viti dhe përmbledhtaz po parashtrojmë rezultatet e tyre.

Për gjurmimin dhe studimin e problemit themelor të historisë sonë të lashtë, atij të etnogjenezës, u zhvilluan me sukses kërkime në vendbanimin prehistorik të Cakranit, të cilat ishin vazhdim i atyre, të filluara që në vitin 1969. Detyrat kryesore të kësaj fushate gërmimi ishin sqarimi i arkitekturës së vendbanimit, i mënyrës së ndërtimit të banesave, përcaktimi sa më i saktë i stratigrafisë dhe rrjedhimisht edhe i moshës së vendbanimit. Gjatë punimeve u verifikuan dhe u plotësuan gjithashtu edhe përfundimet e arritura vitin e kaluar.

Gërmimet e këtij viti u zgjeruan në pesë pika të reja. Ato vazhduan të zbulojnë mbeturina banesash me vatra, tabani i të cilave ishte shtruar me gurë lumi të vegjël; fragmente qeramike dhe kocke, furra, sikurse dëshmojnë rrënojat e shumta prej balte të pjekur, vegla pune prej guri e kocke, qeramikë të zbuluar me motive të ndryshme, skulptura antropomorfe, kocka kafshësh etj.

Zbulimet e reja treguan edhe njëherë qartë karakterin e këtij vendbanimi, dhe vërtetuan mendimin e shprehur vitin e kaluar mbi tipin e vendbanimit, banesat e të cilit janë vendosur nën tokë ose pjesërisht nën tokë, pjesërisht mbi sipërfaqe.

Gërmimet e sivjetme sqaruan edhe më mirë moshën e këtij vendbanimi. Shtresa kulturele, e zbuluar këtu, e cila formohet nga dy horizonte banimi, i përket një epoke të vetme. Vrojtimi me kujdes i qeramikës së zbuluar, analiza më e thelluar tipologjike e ornamentale e saj, mënyra origjinale e trajtimit të figurave antropomorfe, teknika primitive e punimit të veglave prej stralli, gjetja me shumicë e ashkelave prej stalli dhe së fundi tipi i vendbanimit, janë disa të dhëna që i shtynë zbuluesit ta konsiderojnë kulturën e Cakranit më të hershme se neoliti i vonë i Maliqit (faza Maliq I) dhe ta datojnë atë në neolitin e mesëm, duke rektifikuar kështu mendimin e shprehur një vit më parë, të mbështetur në të dhënat fushore, se kjo kulturë i takon epokës së bakrit.

Një qendër tjetër e rëndësishme e kërkimeve prehistorike ka qenë vendbanimi i Kamnikut, ku punimet vazhduan tre vjet me radhë. Gërmimet në këtë qendër nxorën në dritë gjurmë të një vendbanimi neolitik. Punimet e këtij viti, që u zhvilluan në një shkallë të gjerë, patën si qëllim saktësimin e stratigrafisë dhe të arkitekturës së vendbanimit dhe studimin më të plotë të kulturës së tij në etapa të veçanta të zhvillimit të saj. Gjatë gërmimeve u përcaktuan gjashtë horizonte banimi, kultura e të cilave nuk ndryshon prej njëri

tjetrit. Ato përfaqësojnë një shtresë të vetme, e cila përputhet me fazën e fundit të neolitit të vonë të Maliqit (Maliq I).

Sivjet u sqarua deri në fund trakti i murit të zbuluar vitin e kaluar, i cili është vazhdim i murit të diktuar që në vitin 1968, dhe që ka patur, me sa duket, funksion mbrojtës. Ky mur paraqet sot për sot konstruksionin më të hershëm fortifikues në territorin e Shqipërisë. Arqitektura përfaqësohet gjithashtu nga mbeturinat e trojeve prej balte të banesave, të cilat përbëhen nga shtresa të holla argjilore sterile shumë të ngjeshura, rrënoja furrash të djegura, të cilat kanë shërbyer për pjekjen e qeramikës, vatra etj.

Gjatë gërmimeve u zbuluan shumë fragmente qeramike dhe enë të plota, vegla pune prej guri, stralli, kocke dhe briri, objekte të lidhura me botën shpirtërore si terakota, enë antropomorfe e zoomorfe, amuleta etj. Veçanërisht bie në sy qeramika e pikturuar me motive dhe ngjyra të ndryshme.

Të dhënat e reja tregojnë se kultura neolitike e Kamnikut paraqet ngjashmëri të mëdha me kulturën e neolitit të vonë të Thesalisë. Prandaj zbuluesit mendojnë se këtu kemi të bëjmë me një kulturë të ardhur nga juglindja, nëpërmjet luginës së Haliakmonit dhe të vendosur së pari në Maliq e pastaj në Kamnik, aty rreth viteve 2700 p.e.sonë.

Edhe këtë vit problemit të kulturës ilire të periudhës së hekurit, zhvillimit dhe veçantive të saja, ju kushtua një vëmendje e posaçme. Me shumë interes vshin gërmimet që u zhvilluan në Çinamak të Kukësit. Gërmimi i sivjetëm është iazhdimi i tre sezoneve të viteve 1967-1969 të punimeve që po ndërmerren në rrethin e Kukësit. U zbulua një material i shumtë keramik dhe metalik, kryesisht të periudhës së hershme të hekurit deri në shek. e IV para e. sonë. Varrimet e mëvonshme qenë më të pakta, megjithëse ato vazhdojnë deri në periudhën e mesjetës së hershme shqiptare.

Sivjet u punua në 11 tuma me lartësi 0.80-3 m. dhe diametër afërsisht deri në 25 cm. Pesë nga tumat u hapën plotësisht, kurse në gjashtë të tjerat u hoq mbulesa e dhcut, duke bërë një punë përgatitore për vitin e ardhshëm.

Tuma është e ngritur me dhe, kurse elementët arkitekturalë në mbrendi të saj, janë me gurë lumi. Gërmimi dha shenja të qarta, që japin mundësi të ndiqet rritja e tumës në lartësi dhe në shtrirje. U kapën brenda një tume deri në tre rrethe gurësh të plotë ose të pjesshëm, respektivisht me to edhe mbulesa të ndryshme prej gurësh lumi. Varret janë të ndërtuar në arka prej gurësh lumi. Tumat janë me varre qendrore. Në një rast (tuma V) varri qendror që i futur në taban, në gropë të rrethuar me mure gurësh.

Gërmimet katërvjeçare në rrethin e Kukësit po bëjnë gjithënjë më të qartë karakterin e materialit, zhvillimin ekonomik të popullsisë në periudha të ndryshme, po japin gjithënjë e më tepër të dhëna për formimin e kulturës së hershme shqiptare edhe në këtë zonë.

Materialet, e zbuluara këtu, u kanë dhënë mundësi arkeologëve që gërmuan të shohin ngjashmëri të shumta me gjetjet e varrezave tumulare të Matit dhe ato të Shkodrës, ngjashmëri kaq të mëdha, saqë në të tri këto krahina ata shohin një kulturë të vetme që mund të përfshihet në kulturën labeate, duke pasur parasysh rolin më të madh politik që luajtën këto fise në të tri këto krahina. Në sa në materialet e nxjerra nga fshatrat Krumë e Kënetë është parë që ka karakteristika më të shumta dardane, qoftë në tipologjinë e enëve, ashtu edhe në motivet e zbukurimit.

Që nga shek. VII para e. sonë kjo krahinë megjithëse zonë malore, pati një kulturë mjaft të zhvilluar, e cila pati një ngritje të madhe të shek. VI-IV para e. sonë. Një bazë e mirë për këtë kanë qenë, me sa duket, pasuritë minerale të krahinës, të cilat nxirreshin dhe shiteshin në krahinat tona bregdetare prej nga vinte edhe malli i importuar, të cilin e gjejmë në tumat e Kukësit.

Me interes për kulturën e hershme mesjetare shqiptare janë edhe zbulimi i vathëve dhe fibulave të kësaj kohe në tumat e Kukësit.

Një tumë tjetër ilire u gërmua sivjet në Bajkaj të rrethit të Sarandës. U zbuluan në të 43 varre dhe u konstatuan në to dy mënyra varrimi: me djegje dhe me vendosje kufome në varr, me rrasa guri. Me djegje ishte edhe varri qendror. Nga gërmimi rezultoi se disa nga varret kanë qenë grabitur që në kohën antike.

Duke u mbështetur në inventarin e varreve arkeologët datojnë tumën në periudhën e hershme të hekurit shekulli XII-IX p.e.re.

Ngjashmëritë, që vihen re, si në arqitekturën e varreve ashtu edhe në inventarin e tyre, me tumat e Vajzës dhe të Dropullit, tregojnë se ndërtuesit e tumës i përkisnin së njejtës popullsi ilire, që banonte edhe në krahinat e tjera të Ilirisë JL. Shtohen kështu të dhënat që përforcojnë mendimin e shprehur edhe më parë mbi etnicitetin ilir të fiseve epirote, duke rrëzuar kështu mendimin e dijetarëve të huaj që i konsiderojnë ato popullsi greke.

Të dhëna të reja nxorën në dritë edhe gërmimet në varrezën tumulare të Kuçit të Zi. Gjatë punimeve të këtij viti përfundoi së hapuri tuma e parë, e cila u gërmua pjesërisht vitin e kaluar dhe u hap tuma e dytë, më e vogël që ndodhej në afërsi të së parës.

Në bazë të materialit shoqërues të varrit qendror të tumës së parë (varri ka qenë ndërtuar me gropë dheu në trajtë këndrejt) mund të përcaktohet me saktësi koha e ngritjes së tumës, në shekujt e parë të mijëvjeçarit të fundit p.e. sonë.

Duke u mbështetur në inventarin e varreve të zbuluara mund të themi se koha e tyre është e ndryshme. Numri më i madh i takojnë periudhës së parë të hekurit dhe vetëm disa të pakta i takojnë periudhës së dytë.

Inventari i varreve në përgjithësi është i njejtë me atë që dhanë varret e zbuluara vitin e kaluar: armë hekuri, zbukurime kryesisht prej bronxi, dhe enë balte, midis të cilave edhe katër enë me pikturim. Materialet që dhanë varret e tumës së dytë, rruaza qelqi e qelibari, gjilpëra dyshe, byzylykë prej bronxi dhe sidomos qeramike (enë balte të periudhës helenistike) tregojnë se kjo tumë është ngritur në periudhën e dytë të hekurit.

Paralelizmat e qarta me tumat e tjera, të zbuluara në vendin tonë e në vise të tjera të Ilirisë, që vihen re në arqitekturën e varreve në rritin e varrimit dhe në format e objekteve të ndryshme, tregojnë që të varrosurit në këtë tuma kanë qenë ilirë.

Gërmimet në varrezën tumulare ilire të Kuçit të Zi janë një kontribut me vlerë në përforcimin e argumentave, të shprehura më parë mbi përkatësinë etnike ilire të qeramikës së pikturuar të hekurit të hershëm, rrjedhimisht dhe atij të bronxit të vonë, si një veçanti lokale e poçarisë së fisit ilir të dasaretëve.

Duke u mbështetur mbi një material të pasur arkeologjik, kryesisht metalik, mund të vërtetohet edhe njëherë me argumente të reja mendimi i shprehur më parë nga arkeologët tanë mbi përkatësinë etnike ilire të banorëve të lashtë të territorit të sotëm të Maqedonisë perëndimore në periudhën e bronxit të vonë dhe të hekurit të hershëm, problem ky rreth të cilit shkencëtarët e huaj kanë shprehur mendime të ndryshme.

Për studimin e kulturës ilire të periudhës së dytë të hekurit me interes kanë qenë gërmimet arkeologjike në qytetin e Antigonesë, të cilat ishin vazhdim i gërmimeve të katër viteve të kaluara. Punimet vazhduan në dy sektorë: B dhe C.

Për t'u njohur më mirë me sistemin urbanistik të qytetit, këtë vit u punua për zbulimin e dy lagjeve të qytetit. Kështu në sektorin B u zbulua rruga kryesore, që lidhte të dy lagjet e qytetit, e gjatë 15 m. dhe e gjerë 5 m. Traseja e rrugës ishte shtruar me kalldrëm. Pothuaj në mesin e saj kalonte një kanal i mbuluar. Në anën veriore të rrugës u zbuluan tre ambiente banimi të një shtëpie të shekullit II-II p.e.sonë.

Në sektorin C vazhduan punimet, për njohjen e plotë të planimetrisë së shtëpisë së banimit, të zbuluar vitin e kaluar, dhe u zbuluan dy ambjente: shtëpia formohet nga një koridor, në të dy anët e të cilit shtrihen ambientet e ndryshme. Në ambientin e anës perëndimore u zbuluan katër pitosa të mëdhenj të ngulur në tokë. Në pitosin e madh u gjetën dy vegla pune prej hekuri, të cilat janë përdorur për regjien e lëkurës. Këto vegla si dhe disa veglave të tjera prej hekuri që kanë shërbyer për prerjen dhe limosjen e lëkurës, tregojnë se këtu ka patur një punishte për regjien e lëkurës.

Gërmime arkeologjike u bënë edhe në Selcë të poshtme, në rrethin e Pogradecit, në kodrën e quajtur Gradishtë. Gjatë gërmimeve u mblodhën shumë fragmente qeramike, të cilat paraqesin një interes të veçantë, pasi ato përfaqësojnë periudha të ndryshme historike, nganjëherë shumë të largëta me njëra tjetrën. Këto prodhime qeramike tregojnë se kodra e Gradishtës ka qënë banuar shumë kohë përpara se të urbanizohej. Të dhënat, e fituara gjatë këtyre gërmimeve megjithëse të pakta, tregojnë qartë se qyteti ilir i Gradishtës i përket shekullit IV p.e.sonë. Datën më të vonë të ekzistencës së këtij qyteti e japin disa fragmente të shekujve III-IV të erës sonë, si dhe një trakt muri i vonë antik.

Këtu u zbuluan edhe disa varre monumentale me një inventar shumë të pasur, gjë që dëshmon për një zhvillim dhe përparim të gjithanshëm të këtij qyteti ilir, në luginën e sipërme të Shkumbinit.

Gërmimet në Lezhë u zhvilluan si në kalanë ilire, ashtu edhe në atë mesjetare. U zbulua një portë në rrethimin e rajonit të sipërm të qytetit antik, që është porta e tetë e hapur deri më sot në këtë zonë të lartë të Lisit. Nga gërmimet në kalanë mesjetare u zbuluan themelet e murit mesjetar të vendosur mbi një shtresë të pastër të shekullit X-XI. Gjithashtu u mblodh dhe një material i pasur arkeologjik i shek. X-XI. Të gjitha këto i çuan arkeologët në përfundimin se fillimet e konstruksionit mbrojtës të kalasë mesjetare i përkasin shek. XI.

Duke u mbështetur edhe në kërkimet arkeologjike të viteve të kaluara zbuluesit arritën në përfundimin se Lisi nuk ka qënë asnjëherë koloni helene, por përkundrazi një qytet i madh ilir me një zeytari e tregëti të zhvilluar, me një kulturë të avancuar qytetare ilire i themeluar aty nga fillimi i shek. IV p.e.sonë.

Për studimin e kulturës së hershme mesjetare shqiptare, dhe lidhur me të për studimin e gjenezës së shqiptarëve, një problem tjetër i rëndësishëm që qëndron në qendër të vëmendjes së arkeologjisë sonë, sivjet u ndërmorën gërmime në kalanë e Pogradecit, në Shurdhah të Shkodrës dhe në Zharëz të Tepelenës.

Gërmimet në kalanë e Pogradecit ishin vazhdim i atyre të vitit 1968. Pas gërmimeve në pikën A doli në dritë një trakt muri rrethues. Në pikën B gërmimet u përqëndruan për nxjerrjen në dritë të murit rrethues dhe për zbulimin e një muri ndarës, që bashkohej me murin rrethues. Në pikën C muri rrethues u gjet shumë i dëmtuar; prej tij është ruajtur vetëm faqja e brendshme.

Edhe në gërmimet e vitit 1970 gjetjet i përkasin tri periudhave: shek. IV-I p.e.sonë, shekujve I-IV e.sonë dhe mesjetës së hershme.

Duke u mbështetur në gjetjet arkeologjike, rezultoi se vendbanimi i vogël ilir i kodrës së Pogradecit u rrethua me mure në shek. IV p.e. sonë; ndoshta në gjysmën e dytë të këtij shekulli. Për shekujt e parë të jetës së vendbanimit të fortifikuar, me shumë interes është qeramika e prodhimit vendas. Interesante janë edhe objektet e importuara nga Italia jugore dhe nga vendet e tjera mesdhetare.

Për rolin e kësaj qyteze desarete dhe për karakterin e prodhimit të saj në shek. IV-II p.e. sonë nuk ka shumë të dhëna. Në shekujt që pasuan dhe në shekujt e parë të erës sonë jeta vazhdoi në qytezë. Qyteza u banua edhe në kohën e vonë antike dhe në mesjetën e hershme.

Materiali arkeologjik, i zbuluar në gërmimet në kanalë e Pogradecit, jo vetëm që tregon për vazhdimësi jete nga koha e lashtë deri në mesjetën e hershme,

por edhe për një kulturë materiale të njejtë me atë të krahinave të tjera të vendit tonë.

Kalaja e Pogradecit u rrënuar dhe banorët e braktisën atë me shtrirjen e pushtimeve të mbretërisë bullgare në Shqipëri në shek. IX. Kur krahina e Pogradecit u pushtua nga turqit kalaja nuk ekzistonte, sepse ajo nuk përmendet në regjistrat turke të shekullit të XV- e XVI. Ishte ruajtur vetëm kujtimi i saj në toponimin sllav Pogradec, sikurse quhej në atë kohë.

Sivjet ishte viti i katërt i punimeve në kalanë e Shurdhahut. Gërmimet u përqëndruan në sektorin A ose në qytetin e poshtëm dhe në sektorin B në qytetin e sipërm. Në të dy sektorët u gërmua në disa pika të ndryshme për të sqaruar disa probleme ende të mbetura të errta nga gërmimet e viteve të kaluara.

Në sektorin A u zbulua një godinë e përbërë prej nëntë ambientesh, në njerin prej tyre dyshemeja është shtruar me pllaka. Për studimin e mëtejshëm të sistemit të fortifikimit të qytetit në sektorin B u zbulua muri rrethues në një gjatësi prej 30 m.

Midis gjetjeve vendin e parë e ze qeramika, ku mbizotëron qeramika e prodhimit lokal.

Ndër gjetjet më të rëndësishme janë 11 copë monedha të kohës bizantine.

Gërmimet e këtij viti në kalanë e Shurdhahut patën rëndësi të madhe, mbasi e bënë akoma më të qartë tablonë rreth jetës së këtij qyteti, si dhe përcaktuan më mirë kohën e ngritjes së tij,

Në mbarim të gërmimeve arkeologët arritën në përfundim se jeta në këtë qytet mesjetar duhet të ketë filluar aty nga periudha e vonë antike (shek. V). Në shekullin VI-VIII, sipas dëshmisë së varrezës së hershme shqiptare, ka pasë ekzistuar një vendbanim i vogël, me të cilin lidhej me sa duket kjo varrezë. Të dhënat numizmatike i kanë shtyrë arkeologët të mendojnë se në shekujt e mëvonshëm XI-XII qyteti u rrit më tej dhe arriti një zhvillim të dukshëm. Në shekujt XII-XV në dokumentat e shkruara qyteti përmendet si një qendër peshkopale. Shkatërrimin e plotë, pas të cilit nuk e mori më veten, qyteti e pati nga pushtojnësit turq, në fund të shekullit XV.

Sivjet u ndërморën për herë të parë gërmime në kalanë e Zharzës. Ato patën për qëllim datimin e kalasë dhe të sqaronin planimetrinë e saj. Punimet u përqëndruan në tri pika: brenda territorit të kalasë, si dhe në dy kullat që përforcojnë muret rrethues. U bë edhe rilevimi topografik i kalasë. Gjatë gërmimeve u zbuluan dy kulla, në formë katrore dhe të rrumbullakët, u zbulua hyrja e kalasë, një rezervuar uji dhe u mblodh një material i konsiderueshëm qeramik. Në bazë të elementeve të arkitekturës dhe të qeramikës kalaja është ngritur në periudhën e vonë antike dhe ka shërbyer si qendër e një garnizoni ushtarak.

Këto ishin qendrat, ku zhvilluan punime ekspeditat e këtij viti dhe përmbledhataz përfundimet e tyre.

FOUILLES ARCHEOLOGIQUES 1970

Le Secteur d'Archéologie de l'Institut d'Histoire et de Linguistique étend toujours davantage le domaine de son activité de recherche. Les travaux ont été faits en plusieurs directions, en concordance avec les tâches qui se dressent devant notre archéologie. Durant 1970 ont été entreprises plusieurs fouilles dans des centres archéologiques importants de l'Albanie, ce qui a permis d'élargir ainsi la sphère des recherches aussi dans des nouveaux centres. Les expéditions signalent de plus en plus de nouveau matériaux, et d'une importance scientifique incontestable. Elles font le jour sur plusieurs questions importantes de l'archéologie et du passé lointain de notre peuple.

Nous reproduirons par la suite les noms des centres et les lieux où ont travaillé les expéditions de cette année, et nous ferons un résumé des résultats qu'elles ont obtenus.

C'est dans le but d'étudier la question fondamentale de notre histoire ancienne, celle de l'ethnogenèse, qu'ont été effectuées des fouilles dans l'agglomération pré-historique de Cakran, fouilles qui représentent la continuation de celles commencées en 1969. Les principales tâches de cette campagne de fouilles étaient celles de faire de la lumière sur l'architecture de l'agglomération, connaître le mode de construction des habitations, fixer le plus exactement que possible la stratigraphie et de là aussi la datation de l'agglomération. Les travaux ont permis également de vérifier et de compléter aussi les conclusions obtenues durant l'année précédente.

Les fouilles de cette année ont été élargies à cinq nouveaux points. Elles ont continué à trouver des restes d'habitations à foyers, dont le plancher était pavé de cailloux de fleuve, des fours, comme le montrent les nombreuses ruines de terre cuite, des outils de silex et d'os, de la céramique décorée à motifs différents, des sculptures anthropomorphes, des ossements d'animaux, etc.

Les nouvelles sources ont montré une fois de plus le caractère de cette agglomération et ont confirmé l'opinion exprimée l'année dernière sur le type du site, dont les habitations se trouvent enfouies dans la terre, ou bien, pour être plus précis, en partie enfouies dans la terre et en partie en surface.

Les fouilles de cette année ont permis de mieux fixer l'âge de cette agglomération. La couche de civilisation qu'y a été mise au jour est formée par deux horizons d'habitation et remonte à une seule époque. L'observation soignée de la céramique dégagée, l'analyse profonde typologique et ornementale, le mode original de traitement des figures anthropomorphes, la technique primitive de fabrication des outils en silex, les nombreux éclats de silex et, enfin, le type d'agglomération, voilà les éléments qui portent les archéologues à considérer la civilisation de Cakran plus ancienne que le Néolithique récent de Maliq (phase Maliq I) et la dater dans le Néolithique moyen, en rectifiant ainsi l'opinion exprimée il y a un an, et appuyée sur les données de campagne, que cette civilisation remontait à l'âge du cuivre.

Un autre centre important de la préhistoire est celui de Kamnik, où les travaux se sont poursuivis pendant trois années. Les fouilles dans ce centre ont mis au jour des traces d'une agglomération néolithique. Les travaux de cette année, qui ont eu lieu sur vaste échelle, ont eu comme objectif la précision de la stratigraphie et de l'architecture de l'agglomération et l'étude plus complète de sa civilisation à des étapes particulières de son développement. Durant les fouilles ont été fixés

également six horizons d'habitation, dont la civilisation ne présente nulle variation. Ils représentent une seule couche qui concorde avec la dernière phase du Néolithique récent de Maliq (Maliq I).

Durant cette année a été déblayé complètement le tronçon de mur mis au jour l'année dernière, qui représente la continuation du mur identifié dès 1968, et qui a eu, à ce qu'il semble, une fonction défensive. Ce mur représente actuellement la construction fortifiée la plus ancienne en Albanie. L'architecture y est représentée, de même, par des restes des habitations en pisé, constituées par de faibles couches d'argile stérile très pressées, des ruines de fours incendiés, qui ont servi à la cuisson de la céramique, des foyers, etc.

Durant les fouilles ont été mis au jour plusieurs tessons de céramique et des vases complets, des objets rattachés au monde spirituel comme des terracottas, des vases anthropomorphes et zoomorphes, des amulettes, etc. On y est frappé surtout par la céramique peinte, à motifs et couleurs différentes.

Les nouvelles données indiquent que la civilisation néolithique de Kamnik offre de fortes ressemblances avec la civilisation du néolithique récent de la Thessalie. C'est pourquoi ses découvreurs croient qu'on y ait affaire à une civilisation arrivée du S.-E. à travers la vallée de l'Haliacmon et installée tout d'abord à Maliq, ensuite à Kamnik, aux environs des années 2700 avant notre ère.

Durant cette année aussi a été consacrée une attention particulière à la question de la civilisation illyrienne de l'âge du fer, à son développement et à ses particularités. Du plus grand intérêt en ce sens ont été les fouilles effectuées à Çinamak de Kukës. Elles représentent la continuation des trois saisons, de 1967-1969. Les fouilles ont restitué un matériel riche, remontant surtout à la période ancienne du fer jusqu'au IV^e siècle avant notre ère. Les sépultures postérieures sont en nombre moindre, quoiqu'on ait leur continuation jusqu'à la période du haut moyen-âge albanais.

Ont été ouverts, en 1970, 5 tumuli, hauteur 0,80-3,0 m., diamètre jusqu'à 35 m.

Le tumulus est construit par de la terre, mais les éléments architecturaux à son intérieur sont faits par des pierres de fleuve. Les fouilles ont fourni des signes évidents qui permettent de suivre l'accroissement du tumulus en hauteur et en extension. A l'intérieur d'un tumulus ont été saisis jusqu'à trois cercles complets ou partiels de pierres, et en rapport avec eux aussi des couvertures différentes de pierres de fleuve. Les tombes sont construites en caisses de pierres de fleuve. Les tumuli sont à sépulture centrale. Dans un cas (le Tumulus V), la tombe centrale rejoignait le niveau du plancher au moyen d'une fosse entourée de pierres.

Les fouilles quadriennales de l'arrondissement de Kukës rendent de plus en plus évident le caractère du matériel, le développement économique de la population à différentes périodes. Ces fouilles concourent à compléter le cadre de la formation de la civilisation haute-médiévale albanaise aussi dans cette contrée.

Les matériaux qu'y ont été découverts ont donné la possibilité aux archéologues de constater des ressemblances nombreuses avec les trouvailles des nécropoles tumulaires de Mati et de celles de Shkodër. Ces ressemblances sont aussi frappantes que dans les trois régions en question on peut voir une civilisation unique, qui peut être comprise dans la civilisation labéatienne, compte tenu du grand rôle qu'ont joué ces tribus dans ces trois régions. Les matériaux récupérés des tumuli de Krume et de Kënete ont fait constater la présence de nombreux éléments dardaniens, soit dans la typologie des vases que dans les motifs de décoration.

A partir du VII^e siècle avant notre ère, cette région, quoique une région de montagne, a connu une civilisation assez développée, qui a connu une grande ascension dans les siècles VI-IV avant notre ère. Une excellente base à cela ont été, à ce qu'il semble, les ressources minérales de la région, extraites

et vendues dans nos contrées littorales, d'où arrivait aussi la marchandise importée, qu'on retrouve dans les tumuli de Kukës.

De l'intérêt pour la civilisation haute-médiévale albanaise offrent aussi les boucles d'oreille et les fibules remontant à cette époque et mises au jour dans les tumuli de Kukës.

Un autre tumulus illyrien a été fouillé cette année à Bajkaj du district de Sarande. On y a dégagé 43 tombes. Deux sont les modes de sépulture qu'on y a constatés: à crémation et à inhumation. A crémation était la tombe centrale. Les fouilles ont permis de constater aussi que quelques-unes de ces tombes ont été maintenues déjà aux temps antiques.

C'est en se basant sur l'inventaire des tombes que les archéologues font remonter le tumulus à la période de l'ancien fer, c'est-à-dire aux siècles XII-IX avant notre ère.

Les ressemblances observées tant dans l'architecture des tombes que dans leur inventaire, avec les tumuli de Vajze et de Dropull, indiquent que les constructeurs du tumulus appartiennent à la même population illyrienne qui habitait aussi d'autres régions de l'Illyrie méridionale. Ces données confirment l'opinion exprimée aussi antérieurement sur l'ethnie illyrienne des tribus épirotes, en réfutant ainsi l'opinion de quelques savants étrangers qui les considèrent une population grecque.

De nouvelles données ont donné au jour aussi les fouilles dans la nécropole tumulaire de Kuçi Zi. Les travaux de cette année ont permis de porter à terme le déblaiement du premier tumulus, commencé l'année dernière, et dans le même temps a été ouvert un autre tumulus, plus petit, se trouvant au voisinage du premier.

La datation de la construction du tumulus aux premiers siècles du dernier millénaire avant notre ère a été possible à établir sur la base de l'inventaire de la tombe centrale du premier tumulus (la tombe est construite en fosse de terre rectangulaire).

C'est en se basant sur l'inventaire des tombes dégagées qu'on peut affirmer que leur époque est différente. Le plus grand nombre de tombes remontent à la première période du fer, et ce n'est qu'un petit nombre de sépultures qui appartiennent à la deuxième période.

L'inventaire sépulcral est en général le même que celui fourni par les tombes dégagées l'année passée: armes de fer, parures surtout de bronze, vases de terre cuite, dont au nombre aussi quatre récipients peints.

Les objets trouvés dans les tombes du deuxième tumulus: perles de verre et d'ivoire, épingles doubles, bracelets de bronze et surtout la céramique (vases de terre cuite de la période hellénistique) indiquent que ce tumulus a été construit dans la deuxième période du fer.

Les parallélismes évidents avec les autres tumuli découverts dans notre pays et dans d'autres régions de l'Illyrie, observés dans l'architecture des tombes, le rite de sépulture et dans les formes des objets, sont à indiquer que les usagers de ces tumuli ont été des Illyriens.

Les fouilles dans la nécropole tumulaires de Kuçi Zi représentent une contribution de valeur à confirmer les arguments avancés antérieurement sur l'appartenance ethnique illyrienne de la céramique peinte du fer ancien, par conséquent aussi de celle du bronze récent, ainsi que des particularités locales de la poterie de la tribu illyrienne des Dassarètes.

Le riche matériel archéologique, surtout celui métallique, permet de confirmer une fois de plus, de nouveaux arguments à l'appui, l'opinion exprimée antérieurement par nos archéologues sur l'appartenance ethnique illyrienne des anciens habitants du territoire actuel de la Macédoine occidentale dans la période du bronze récent et du fer ancien. Sur cette question, les archéologues étrangers ont avancé des opinions disparates.

De l'intérêt offrent aussi les fouilles archéologiques dans la ville d'Antigonée

pour l'étude de la civilisation illyrienne de la deuxième période du fer. Celles-ci étaient la continuation des fouilles effectuées durant les quatre dernières années. Les travaux ont continué dans deux secteurs: B et C.

Afin de mieux connaître le système d'urbanisme d'Antigonée, on a travaillé cette année à dégager deux quartiers. Dans le secteur B a été dégagée la rue principale qui reliait les deux quartiers de la ville, longue 15 m. et large 5. Le tracé était dallé. Presqu'à son milieu passait un canal couvert. La partie N. de l'agglomération citadine a donné trois milieux d'habitation d'une maison des siècles III-II avant notre ère.

Dans le secteur C ont continué les travaux à connaître complètement la planimétrie de la maison d'habitation dégagée l'année dernière. La maison est formée par un corridor des deux côtés duquel s'étendent les différents milieux. Le milieu 0. a donné quatre grands pythoi fixés au sol. Le grand pythos avait deux outils de fer, utilisés pour le tannage du cuir. Ces outils ainsi que d'autres instruments de fer servant à la manipulation des cuirs montrent qu'on est en présence d'un atelier de tannage.

Des fouilles ont eu lieu aussi dans la Basse-Selce, arrondissement de Pogradec, sur une éminence qu'on appelle Gradishte. Ont été ainsi réunis plusieurs tessons de céramique, qui offrent un réel intérieur, du fait qu'ils représentent différentes périodes historiques, souvent très lointaines les unes des autres. Ces articles de céramique confirment que la colline de Gradishte a été habitée de beaucoup antérieurement à son urbanisation. Les données acquises durant ces fouilles, quoique en petit nombre, indiquent parfaitement que la ville illyrienne de Gradishte remonte au IV^e siècle avant notre ère. La date la plus récente de l'existence de cette cité est fournie par quelques tessons de céramique des siècles III-IV de notre ère, ainsi que par un tronçon de mur de la basse antiquité.

A cet endroit ont été dégagées aussi des tombes monumentales qui ont donné un inventaire extrêmement riche, ce qui confirme le développement et le progrès à tout égard de cette ville illyrienne dans la haute vallée du Shkumbin.

Les fouilles à Lesh ont eu lieu tant dans la forteresse illyrienne que dans le château fort médiéval.

La forteresse illyrienne a donné une porte dans la ceinture de la partie supérieure de la cité antique, qui représente la huitième porte ouverte jusqu'à présent dans ces parages de Lissus.

Les déblaiements dans le château fort médiéval ont mis au jour les fondations du mur médiéval qui repose sur un sol stérile des siècles X-XI. De même, a été réuni un riche matériel archéologique des siècles X-XI. Toutes ces constatations ont porté les archéologues à la conclusion que les premières constructions de caractère défensif du château fort médiéval remontent au XI^e siècle.

Appuyés aussi sur les recherches archéologiques des années dernières, les découvreurs ont abouti à la conclusion que Lissus n'a jamais été une colonie hellénique, mais qu'en revanche Lissus a été une grande ville illyrienne, avec un artisanat et commerce développés, avec une civilisation citadine avancée. La ville a été fondée vers le commencement du IV^e siècle avant notre ère.

L'étude de la civilisation haute-médiévale albanaise, et en rapport avec elle, aussi l'étude des origines des Albanais proprement dits, ont porté à entreprendre durant 1970 des fouilles dans la forteresse de Pogradec, à Shurdhah (la Sarda ancienne de Shkodër) et à Zharëz de Tepelene.

Les fouilles dans la forteresse de Pogradec représentaient la continuation de celles de 1968. Le point A a restitué un tronçon du mur de ceinture. Pour le point B, les fouilles ont été centrées à dégager le mur de ceinture et à déblayer un mur de séparation qui s'unissait au mur de ceinture. Au point C, le mur de ceinture a été trouvé très endommagé. De celui-ci n'a été conservée que la paroi intérieure.

Pour les fouilles 1970, également, les trouvailles remontent à trois périodes: les siècles IV-I avant notre ère, les siècles I-IV de notre ère et le haut moyen âge.

Les trouvailles archéologiques ont permis d'établir que la petite agglomération illyrienne de la colline de Pogradec a été ceinte de murs au IV siècle avant notre ère, probablement dans la deuxième moitié de ce siècle. Pour les premiers siècles de la vie de l'agglomération fortifié, le plus grand intérêt l'offre la céramique locale. Intéressants sont aussi les objets importés de l'Italie méridionale et des autres pays méditerranéens.

On n'a pas, pourtant, beaucoup d'éléments sur le rôle de cette ville d'assarète et du caractère de sa production dans les siècles IV-II avant notre ère. Dans les siècles suivants et les premiers siècles de notre ère, la vie a continué dans cette cité. La cité était habitée aussi dans la basse antiquité et le haut moyen âge.

L'inventaire archéologique restitué par les fouilles dans la forteresse de Pogradec illustre non seulement la continuation de la vie depuis les temps antiques jusque dans le haut moyen âge, mais il fait état aussi d'une culture matérielle identique à celle des autres contrées de notre pays.

La forteresse de Pogradec fut détruite et ses habitants l'abandonnèrent à la suite de l'extension du royaume bulgare dans les provinces albanaises au cours du IXe siècle. Lorsque la région de Pogradec fut conquise par les Turcs, la forteresse n'existait plus, les cadastres turcs des siècles XV^e et XVI^e ne portant nulle mention de celle-ci. Il n'en restait plus que son souvenir dans le toponyme slave de Pogradec, comme elle était appelée à cette époque.

1970 a représentée la quatrième année des travaux dans le château fort de Shurdhah (la Sarda médiévale). Les fouilles ont été centrées dans le secteur A, ou bien dans la ville basse, et dans le secteur B ou bien la ville haute. Les deux secteurs ont fait l'objet de déblaiements à différents points afin de mettre au clair plusieurs questions restées encore estompées durant les fouilles des années passées.

Le secteur A a restitué un édifice comportant neuf pièces. Dans l'une de celles-ci le sol est pavé de planches. Afin d'étudier plus à fond le système de fortifications de la ville, dans le Secteur B a été déblayé le mur de ceinture sur une longueur de 30 mètres.

Du nombre des trouvailles, la première place va à la céramique, où prédomine la céramique de fabrication locale. Dans l'inventaire figurent aussi 11 monnaies de la période byzantine.

Les fouilles de cette année dans le château fort de Shurdhah ont leur importance, parce qu'elles ont permis de rendre plus clair le tableau sur la vie de cette ville et dans le même temps ont mieux déterminé le temps de sa fondation.

A la fin de leurs fouilles les archéologues ont abouti à la conclusion que la vie dans cette ville médiévale doit avoir commencé vers la basse antiquité (V^e siècle). Dans les siècles VI-VIII, comme on le constate dans l'ancienne nécropole albanaise, a existé une petite agglomération à laquelle se rattachait, selon toute vraisemblance, cette nécropole.

Les éléments numismatiques ont porté les archéologues à supposer que dans les siècles postérieurs, et précisément dans les siècles XI-XII, la ville grandit encore et parvint à un développement remarquable. Dans les siècles XII-XV, la ville figure dans les documents écrits comme un siège épiscopal. La destruction totale, à la suite de laquelle la ville n'a pu plus se reprendre, a lieu de la main des conquérants turcs, à la fin du XV^e siècle.

Cette année ont été entreprises des fouilles, pour la première fois, dans la forteresse de Zharze. Le but a été celui de dater la forteresse et de connaître sa

planimétrie. Les travaux ont été centrés sur trois points: à l'intérieur de l'emplacement de la forteresse et dans les deux tours qui renforcent les murs de ceinture. A été fait également le relevé topographique de la forteresse.

Les fouilles ont permis de déblayer les deux tours, l'une rectangulaire, l'autre ronde. A été dégagée également l'entrée de la forteresse, une citerne pour le rassemblement de l'eau et a été réuni un nombreux inventaire céramique. La forteresse doit avoir été fondée, sur la base des éléments d'architecture et de la céramique, dans la basse antiquité et elle doit avoir servi à cantonner une garnison militaire.

LISTA E SHKURTIMEVE

- A. S. A. Arkivi i Sektorit të Arkeologjisë
- B. A. Buletin Arkeologjik
- B. C. H. Bulletin de Correspondance Hollénaïque
- B. I. SH. Buletin i Institutit të Shkencave
- B. S. A. The Annual of the British School of Archaeology at Athens.
- B. SH. SH. Buletin për Shkencat Shoqërore
- B. U. SH. T. SH. SH. — Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria Shkencat Shoqërore
- I. A. I. Izvestia na Arheologičeskija Institut.
- K. I. S. A. Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike
- K. II S. A. Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike
- M. I. A. Materiali i islodovanii po arheologi SSSR
- S. A. Studia Albanica
- S. H. Studime Historike
- W. M. B. H. Wissenschaftliche Mitteilungen aus Bosnien und der Herzegowina
- Z. f. E. Zeitschrift für Ethnologie

NDREQJE GABIMESH

<i>Nr. Faqes</i>	<i>Rreshti</i>	<i>Është shkruar</i>	<i>Lexohet</i>
9	1	elirimtë	çlirimit
9	2	vëndit	të vëndit
9	24	reja	të reja
9	25	tlështu	kështu
9	26	ëirëve	ilirëve
31		UZAFER	MUZAFER
33	7	fig. 3. ab	nuk duhet
36	8	Maliqi II	Maliqi III
36	35	ngjyrë	grykë
59	35	Tab X	Tab. VII
78	8	ngjyrë	zgjyrë
133	2	i	si
160	28	0,12 cmt	0,12 m.
177	36	trup	trup
182	5	Tab. XXI 5.6	Tab. XXIX 5.6
186	50	mbathen	mbahen
193	11	Tab XLV. 1	Tab XLIV. 1
196	18	Tab XXXVI. 4, 6, 7	Tab XLVI
223	5	Tab. VIII nr. 4	Tab XII nr. 4
223	11	Tab VIII nr. 3	Tab. XII nr. 3
230	12	eksploruar	eksploruar
230	18	ivizite	vizitë
240	34	radhë	rathë
245	33	shënonte	shënonte
255	23	Tab VIII. 7	Tab. VII. 7
263	1	jagëlindje	verilindje
271	2	Tab IV. 4	Tab. IV. 5
271	4	Tab. IV. 5	Tab. IV. 4
271	26	8 cm	0,8 cm
271	33	Krujës	Krujë
273	11	herhme	hershme (19)
291	19	Ceka	Ceka
293	12	sas	saj
293	36	valey	valët
299	8	henike	helenike
301	16	lt	l
301	39	Tloqe	Bloqe
301	43	fig. 32	të mos lexohet
303	33	lindje	lindje
306	15	anë	në
307	50	5 km	5 m
309	1	nrme grënite dërtu	ndërtuar me gurë të
309	4	Kallcan	Mallcan
315	3	Tab XV. 24	Tab XV. 2, 3
315	25	fshat	fshatari
316	21	Tab XII. 1 dhe fig. 27	Tab. XVI. 1 dhe fig. 27
325	24	Tab XXII. 2	Tab. XXI. 2.
327	15	Tab XXIII. 1	Tab. XXII. 1
327	16	Tab XXIII. 2	Tab. XXII. 2
327	18	Tab XIX. 1	Tab. XXIII. 1
327	30	Tab XXXIII. 2	Tab. XXIII. 2
328	22	para	pala
332	2	Tab XXXIII. 1-3	Tab. XXVI. 2
332	2	Tab XXI. 1, 2	Tab. XXVI. 1
332	17	Tab XXXVIII. 4	Tab. XXVIII. 4
334	35	Tab XXXIX	Tab. XXIX
335	12	rikuadro	kuadro
336	30	Tab XXX	mos të lexohet